


Digjitalizimi i financave publike: Revolucioni dBrain⁺ i Koresë në kontabilitetin me të drejt a dhe detyrime të konstatuara

Reformimi i rakordimeve dhe raportimit financiar shtetëror në
Kore

12 nëntor 2025



Formimi i së ardhmes së SIMF-së me përvojën e dBrain⁺ të Koresë





Përmbajtja


1. Pamje e përgjithshme e sistemit informativ të financave buxhetore të Koresë
2. Çfarë është dBrain+
3. Moduli i rakordimit i dBrain+
4. Historik i kontabilitetit kombëtar në Kore
5. Institucionet kombëtare të kontabilitetit
6. Procedura e rakordimit në nivel qendror
7. Përbërja e evidencave të rakordimit në nivel qendror
8. Ndryshime në sistemin e informacionit
9. Arritjet
10. Projekti i reformës së evidencave të rakordimit në nivel qendror



Pamje e përgjithshme e KFIS-së & historik i SIMF-së së Koresë



“ Shërbimi i Informacionit Financiar i Koresë (KFIS) administron dhe shfrytëzon sistemin dBrain (Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar të Koresë) prej vitit 2016.




(1) FIMSYs : Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Financiar
 (2) NaFIS : Sistemi i Informacionit Financiar Kombëtar

Agjencitë e menaxhimit të financave publike në vende të tjera	SHBA Departamenti i Thesarit (Zyra e Shërbimit Buxhetor)	Agjencia për Informatikën Financiare të Shtetit, Francë (AIFE)	Ministria Federale e Financave, Gjermani (ZIVIT)



“ dBrain+, Sistemi i Integruar i Informacionit për Menaxhimin Financiar (SIIMF) i Koresë, administron të gjithë ciklin buxhetor dhe mbështet vendimet e politikave të mbështetura në të dhëna në të gjithë komponentët: Sistemi Qendror i Menaxhimit Financiar, Sistemi i Lidhur Financiar, Sistemi i të Dhënave të Financave Buxhetore dhe të Dhënat e Hapura për Financat Buxhetore.



Nga mbështetja për detyrat buxhetore te mbështetja për vendimmarrje në kohë e duhur për politika mbështetur në të dhëna



B. Sistemi i lidhur financiar

Integrim me 81 institucione dhe 144 sisteme



C. Sistemi i të dhënave të financave buxhetore (FDS)

Shërbime analitike të mbështetura në të dhëna dhe mbështetje për vendim marrjen për politikat



D. Të dhëna të hapura për financat buxhetore


Dhënia e informacioneve shpjeguese për financat buxhetore, në mënyrë të qartë, të arritshme dhe transparente

* dBrain është kombinim i 'D', që do të thotë "digjital", dhe Brain që do të thotë "tru", pra "tru digjital".

- Moduli i rakordimit i dBrain+ (1/2)



Moduli i rakordimit në dBrain+ harton statistika të financave të qeverisjes për mbarë vendin dhe thjeshton hartimin e evidencave të mbylljes, me një sistem të automatizuar të regjistrimit në ditë si një nga funksionet e tij kryesore.




※ Burimet: KFIS po vendos standardin global për menaxhimin digjital të financave kombëtare, KFIS.

- Moduli i rakordimit i dBrain+ (2/2)



“ Më poshtë ilustron se si sistemi i automatizuar i regjistrimit në ditar i dBrain+ mbështet zbatimin e buxhetit dhe bën pa pro bleme regjistrime kontabël me të drejta dhe detyrime të konstatuara.



Historik i kontabilitetit kombëtar në Kore



“ Në vitin 2011, Koreja futi në përdorim kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara për t’u dhënë zgjidhje kufizime ve që vinin nga mbështetja vetëm në të dhënat buxhetore në vlerësimin e situatës performancës financiare të qeverisë.

- Kontabilitet buxhetor me bazë monetare (Kontabilitet me regjistrim të njëfishtë)
- Shpallja e politikës për të futur në zbatim sistemin e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara
- Projekti i ligjit kombëtar të kontabilitetit

1960 ~

1998

2003

2007

- Miratimi i ligjit kombëtar të kontabilitetit
- Ngritja e sistemit dBrain (SIMF i gjeneratës III)

2011

2010

2009

- **Futja në zbatim e sistemit të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara** (kontabiliteti me regjistrim të dyfishtë)
- Ngritja e Qendrës për Statistikat Kontabël dhe Financave të Qeverisë

Vendosja e standardeve kombëtare të kontabilitetit
Zbatimi pilot i sistemit të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në qeverisjen qendrore

2012

2022

2025

- Në vitin ushtrimor 2011, iu paraqitën për herë të parë pasqyrat financiare Asamblesë Kombëtare.
- Prezantimi i dBrain+ (SIMF i gjeneratës IV)
- **Reforma e evidencave të rakordimit financiar në nivel qendror**
- Thjeshtimi i evidencave kryesore financiare (pozicioni financiar, operacionet dhe ndryshimet në aktivet neto)
- Futja në përdorim e pasqyrës së flukseve monetare me metodën e drejtpërdrejtë.

Institucionet kombëtare të kontabilitetit



“ Institucionet që mbështesin sistemin e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara të Koresë përbëhen nga Ligji Kombëtar i Kontabilitetit, Vendimi në zbatim të Ligjit Kombëtar të Kontabilitetit dhe aktet nënligjore për Standardet e Kontabilitetit të Qeverisjes Qendrore.




※ Burimet: Akti nënligjor në zbatim të Standardeve të Kontabilitetit të Qeverisjes Qendrore, MOEF & KIPF

Procedura e rakordimit në nivel qendror



“ Procedura e rakordimit në nivel qendror në Kore kryhet në shtatë faza.




※ Burimet: Informacion Mujor i Financave Publike, qershor 2019, Vëll. 30, FIS

Përbërja e evidencave të rakordimit në nivel qendror



“ Evidencat e rakordimit në Kore përbëhen nga një përmbledhje e rakordimit, rakordimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrat financiare dhe një raport i performancës.



Ndryshime në sistemin e informacionit (1/3)



“ Kategoritë e ndryshimeve në sistemin dBrain+ për rakordimin financiar nga viti 2017 deri në vitin 2023 mund të klasifikohen në këto shtatë lloje.

Llojet e përmirësimeve të funksioneve të sistemit të rakordimit financiar në dBrain+ (2017 ~ 2023)



Funksionet e verifikimit të rakordimit financiar



Funksionet e kontrollit të përputhshmërisë të rakordimit financiar



Evidencat e rakordimit financiar (mbledhja & modifikimi)



Funksionet e lidhjeve të rakordimit financiar



Ndryshime funksionale të rakordimit financiar për shkak të përmirësimit të procedurave



Ndryshime funksionale të rakordimit financiar për shkak të riorganizimit organizativ të qeverisë




Ndryshime funksionale për përmirësimin e lehtësisë për përdoruesit

Ndryshime në sistemin e informacionit (2/3)



“ Në grafikun e mëposhtëm jepen statistikatat për llojet e ndryshimeve në sistemin dBrain⁺ për rakordimin financiar nga viti 2017 deri në 2023.

Ecuritë vjetore të ndryshimeve funksionale në modulën e rakordimit financiar në dBrain⁺




✘ Burimet: Rindërtuar nga autori mbështetur në të dhënat e brendshme të Shërbimit të Informacionit Financiar të Kosovës

Ndryshime në sistemin e informacionit (3/3)



“ Në grafikun e mëposhtëm jepet rezultati i 7 llojeve të ndryshimeve në sistemin dBrain+ për rakordimin financiar nga viti 2017 deri në 2023.

Statistikat e përmirësimeve funksionale sipas llojit për modulën e rakordimit Financiar në dBrain+





Institucionet

- + Mbështetja e planifikimit buxhetor afatmesëm dhe afatgjatë dhe vlerësi mi i qëndrueshmërisë buxhetore nëpërmjet identifikimit të detyrimeve e mundshme siç janë provizionet për pensionet përmes informacionit të bollshëm financiar.
- + Administrimi i gjithanshëm dhe sistematik i aktiveve kombëtare nëpërmjet kontabilizimit të pasurive, mallrave, obligacioneve, infrastrukturës dhe aktiveve të tjera në proces.
- + Rritja e besueshmërisë së shifrave financiare kombëtare, përfshirë statistikat e borxhit të raportuara nga qeveria
- + Përfshirja në objektin e statistikave financiare kombëtare e standardit të përgjithshëm të qeverisë, përfshirë institucionet publike, dhe përmirësimi i krahasueshmërisë ndërkombëtare dhe besueshmërisë së shifrave financiare.
- + Mundësimi i menaxhimit financiar të mbështetur në performancë përmes analizës së kostos në nivel programi

Sistemi informacionit & Mbështetja e përdoruesit

- + Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe regjistrimi të dyfishtë, i lehtë për t'u përdorur, i mundësuar nga regjistrimi automatik në dBrain+.
- + Mbështetja e zgjidhjeve të mira financiare nga nëpunësit kontabël përmes asistencës për përdoruesit gjatë periudhave të pikut, programeve të formimit dhe manualeve të gjithanshme.
- + Zbatim fleksibël i kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara nëpërmjet dBrain+ (softuer i zhvilluar në vend) dhe FIS, që reagon ndaj ndryshimeve institucionale dhe të politikave.
- + Luajtja e një roli vendimtar në krijimin e raporteve të rakordimit financiar dhe dhënia e informacioneve shpjeguese financiare përmes dBrain+ në mënyrë shumëpalëshe

Fusha për përmirësime

1. Rritja e përdorshmërisë së informacionit kontabilël në nivel qendror të mbështetur në sistemin me të drejta dhe detyrime të konstatuara për të mbështetur një zbatim dhe vendimmarrje më të gjerë.
2. Rritja e mundësisë për informim të publikut duke paraqitur informacionin kontabël në nivel qendror dhe raportet financiare në një format më të thjeshtë dhe më të qartë.

Reforma e evidencave të rakordimit financiar në nivel qendror (1/3)

Emri i projektit

Projekti i reformës së evidencave të rakordimit financiar në nivel qendror

Periudha e zbatimit

maj 2024 – dhjetor 2025

Konteksti i Projektit

Nivel i ulët përdorimi në krahasim me punën e investuar në krijimin e evidencave të rakordimit

1

Përdorimi i terminologjisë komplekse, të gjerësishme dhe teknike, që është e vështirë për t'u kuptuar nga publiku i gjerë

2

Një numër i madh zërash të llogarive publike, çka e bën të vështirë të kuptohet me një shikim pamja e përgjithshme

3

Mungesa e një pasqyre të flukseve monetare me paraqitje të qartë të lëvizjeve të likuiditetit të vendit

Përmbledhje e evidencave aktiale të rakordimit

Gjithsej
1 473
faqe

I Informacion i përgjithshëm mbi rakordimin

Pamje e përgjithshme e evidencave të rakordimit, kushtet ekonomike	5 faqe	• Përgatitja dhe zbatimi i Buxhetit	10 faqe
• Bilanci i financave buxhetore dhe borxhi kombëtar	7 faqe	Përmbajtja kryesore e evidencës së rakordimit	44 faqe

II Rakordimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

• Përmbledhje	128 faqe	• Rakordimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas llogarive	506 faqe
Rakordimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas fondeve	225 faqe	Rakordimi sipas sektorit dhe programit	126 faqe

III Pasqyrat Financiare

• Pasqyra e pozicionit financiar	5 faqe	• Pasqyra e operacioneve financiare	6 faqe
Pasqyra e ndryshimeve në pasurinë neto	2 faqe	• Shënimet e pasqyrave financiare	69 faqe
Informacione shtesë të kërkuara	236 faqe	• Shtojca	42 faqe

IV Raporti i performancës

Përmbledhja e raportit të performancës, përmbajtja kryesore dhe statusi i arritjeve sipas programit dhe projektit

Reforma e evidencave të rakordimit financiar në nivel qendror (2/3)



Produktet e projektit

1. Krijimi i një sistemi të ri plani kontabël (PK) në përputhje me kornizën e rishikuar të rakordimit në nivel qendror

- Miratimi dhe zbatimi i strukturës së përditësuar të PK-së për të thjeshtuar hartimin dhe dorëzimin e evidencave të rakordimit, si dhe për të rritur përdorshmërinë dhe arritshmërinë për publikun

2. Riorganizimi dhe thjeshtimi i pasqyrës së pozicionit financiar

- Llogaritë tani paraqiten si zëra me një rresht unik në pasqyrën e pozicionit financiar, pa dallime mes afatshkurtrave ose afatgjatave. Por ky klasifikim mbetet në nivelin e nënllogarive (niveli III dhe më poshtë).
- Thjeshtimi i llogarive të nivelit 2 për aktivet (financiare, të trupëzuara/të patrupëzuara dhe aktive të tjera) dhe pasivet (huamarrje, provizione dhe të tjera) në pasqyrën e pozicionit financiar në tri kategori secila.

3. Futja në përdorim i pasqyrave të operacioneve financiare sipas sektorit dhe klasifikimit ekonomik

- Vendosja e pasqyrave financiare sektoriale për të harmonizuar kostot me funksionet buxhetore, duke lidhur kontabilitetin buxhetor dhe financiar për të mbështetur administrimin e programeve dhe vendimet buxhetore në mbarë qeverisjen.
- Futja në përdorim e pasqyrave të operacioneve financiare sipas klasifikimit ekonomik për të përmirësuar përdorshmërinë dhe vlerën analitike, duke mundësuar identifikim më intuitiv të të ardhurave dhe shpenzimeve mbështetur në natyrën e veprimeve.

4. Futja në përdorim e pasqyrës së flukseve monetare me metodën e drejtpërdrejtë

- Paraqitja e flukseve hyrëse dhe dalëse të vendit sipas veprimtarive të shfrytëzimit, të investimit dhe të financimit, për të mundësuar krahasime vjetore dhe për të plotësuar rezultatet e rakordimit buxhetor (p.sh., duke dalluar shpenzimet kapitale sipas blerjes së aktiveve dhe njohjes së shpenzimeve).

5. Vënia në zbatim e një sistemi të konsoliduar të shënimeve

- Unifikimi i shënimeve, informacioneve plotësuese të kërkuara dhe shtojcave në një format të vetëm përshkrues të dhënies së informacioneve shpjeguese për të përmirësuar qartësinë, qëndrueshmërinë dhe për të siguruar zbulimin e plotë të hollësive të bashkëlidhura më parë.



Përfitimet e pritura

- 1 Rritja e njohurive të publikut përmes pasqyrave financiare të thjeshtuara**
 - Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e operacioneve financiare janë shkurtuar nga 8 dhe 6 faqe, përkatësisht, në vetëm një faqe secila.
 - Numri i zërave të shënimeve shpjeguese në pasqyrën e pozicionit financiar është zvogëluar nga 102 në 32, dhe në pasqyrën e operacioneve financiare nga 76 në 27.
- 2 Rritje e krahasueshmërisë midis buxhetit dhe pasqyrave financiare përmes pasqyrës së re të operacioneve financiare sektoriale**
 - Jep të dhëna të gjithanshme për kostot totale, të ardhurat dhe kostot neto sipas secilit sektor buxhetor, çka mundëson krahasim dhe analizë më efektive.
- 3 Rritje e kapacitetit për analizë të flukseve monetare shtetërore**
 - Mundëson vlerësimin e cilësisë dhe analizën e trendit të flukseve monetare të qeverisë duke kategorizuar hyrjet dhe daljet sipas veprimtarive të shfrytëzimit, të investimit dhe të financimit.

Thank you

Formimi i së ardhmes së SIMF-së me përvojën e dBrain+ të Koresë

Sangwook(Paul) Nam | wujunam@fis.kr